



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 3074 prot.

Tiranë, më 21 . 11 .2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1949, DATË 08.07.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. FRAN DASHI”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Fran Dashi nr. 123 prot., datë 12.01.2023 dhe nr. 123/2 prot., datë 23.01.2023, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve A.K. me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, F.B. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, N.T. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 1949 prot., datë 08.07.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Fran Dashi”, bazuar në nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga “Don Bosko”, Kompleksi “Vizion Plus”, Kulla 3, Shkalla 1, Apartamenti nr. 6, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

